

Gjenealogjia dhe Forca e Dashurisë

Ç'është Dashuria?: Një Hulumtim Gjenealogjik!

Ylli Përmeti

I Shenjti Valentin iku, dhe shumë “ndoshta” rinovuan ndjenjat e tyre kundrejtë dashurisë së tyre – në tërë botën perëndimore. Dhe kjo për vetë faktin se dashuria, ky kompleks i çuditshëm ndjenjash, i imponohet shoqërisë civile institucionalisht që nga koha e lindjes së filozofisë normative. Por ç'është dashuria si koncept?

Abstrakt

Dashuria kundrejtë partnerit, kundrejtë prindërve, kundrejtë kafshës, vetes, institucioneve apo natyrës, shfaqet me nuanca të ndryshme. Ky ndryshim nuancash do të trajtohet në këtë tekst duke vënë ballë-për-ballë edhe një nocion tjetër, që është e vërteta në vetë-vete. Kjo e vërtet më shumë institucionale se sa natyrale rivendikon dashuri normative dhe jo natyrale. Rrjedhimisht, pyetja që shtrohet është: A mund të jetë dashuria normative? Nëso po, a nuk duket një dashuri e tillë skllavëruese? Për më shumë, është dashuria varësi apo pavarësi?

Ndonëse dashuria si koncept në një kundrim sipërfaqësor paraqitet si një fjalë pa shumë komplekse ajo fsheh shumë të vërteta në brendësi të saj. Kështu, dashuria ashtu sikurse edhe koncepte të tjera

sociale ka të bëjë me gjetjen, hamendësimin apo relativizimin e të “vërtetës” nga akt-marrësi kundrejtë objektit apo subjektit. Kjo dashuri, që është pothuajse e njëjtë jo vetëm kundrejtë njeriut që zgjedhim në jetë por edhe kundrejtë vëndit ku kemi lindur, institucioneve, njerëzve me të cilët jemi rritur, kafshëve dhe çuditërisht edhe bimëve – ndonëse duke u reduktuar ndaj kësaj të fundit, ka të vërtetat e saj të pa-thëna. Ky tekst do të ri-ekzaminoj dashurinë që mbartim kundrejtë bashkëshortit që zgjedhim në jetë, pa lënë në harresë dashurinë prindërore dhe atë të mëmëdheut; ndërsa dashurinë për artin, historinë, shkencat ekzakte apo sociale, do t’i trajtojmë pak më tutje.

Kështu, të duash dikë si bashkëshort për jetën tonë, është më të vërtet një sfidë e madhe dhe shumë e mundimshme, për të dyja gjinitë. Siç edhe duket qartë nga të gjithë ne, dashuria shumë shpesh ngërthehet me nocione të tjerë social, por ajo ngërthehet më shumë se asgjë tjetër, me moralin. Në të vërtet, çdo ndjenjë apo akt social ngërthehet nga shumë filozofë normativë, me moralin: Është një lloj si të thuash se jetojmë gjithë-moralin social. Por në realitet, dashuria i nënshtrohet rregullave të saj natyral, që në dukje – janë kaq të pa hulumtueshëm. Këto rregulla të paqartë dhe të paidentifikueshëm, dhe veçanërisht të parratur nga shoqëritë civile – për hir të dashurisë [!], përbëjnë edhe ngërçin më të madh të gjithë shtresave sociale. Kjo ndodh për vetë faktin se kushdo nga ne, kërkon të dashurohet dhe të dashuroj pashtershmërisht. Kjo ndjenjë, ndonëse në hapat e saj të parë është entuziaste, më pas ajo venitet. Evidentisht, arsyet variojnë.

Elementët që ky tekst do të vër në dukje, si fillim, për të interpretur dashurinë në thellësi të saj, janë dy nocione të tjerë human: Dëshira dhe zemërimi. Çdo njëri nga këta komponentë, është pjesë përbërse e qënies njerëzore, dhe rrjedhimisht asnjëri nga ne nuk i shpëton dot këtyre komponentëve përbërës. Dëshira në këtë kontekst ka të bëjë me të bukurën, në stadin e parë të përçapjes sonë kundrejtë një individi koniuktural. Dhe kështu, të gjithë themi: Partnerin e dua me x përmasa, dhunti apo virtyte. Njëllor sikurse themi për dëshirën tonë ndaj profesionit, shtëpisë apo vëndit ku duam të banojmë. Por kjo dëshirë duket se është edhe “natyrale” edhe e “indoktrinuara” nga mjetet e komunikimit masivë.

Natyrally, është sepse çdo njëri nga ne ka dëshirën e vetë për të zgjedhur duke u bazuar si fillim te joshja e ndërsjellë. Joshja në ditët tona është quajtur nga fiziokimistët si “kimi” koherente. Pra është një bashkim kimik që ndodh brenda nesh dhe n’a shtyn natyralisht të dërgojmë mesazhe apo xheste trupore kundrejtë asaj që n’a josh, në mënyrë spontane. Në këtë stad të joshjes, nuk duhet të harrojmë të gjithë ata që nuk e njohin këtë stad, pra të gjithë ata që interkorsën e tyre e kanë rutinë dhe jo lojë ndjenjash apo interkorsë kimike; dhe këta janë dhunuesit fizikë. Kjo interkorsë kimike në këtë stad, nuk ndërthur pyetje të tjera logjike, sikurse janë pyetje të llojit: A është ky individ, njeriu i *duhur* që zgjedhim për këtë interkorsë, flirt apo dashuriçkë? Natyrisht që çdo njëri nga ne nuk ka mundësinë mendore dhe perceptuese që t’i jap përgjigje kësaj pyetje (nëse ia bën vetes!) në hapat e parë të pushtimit emocional.

Ndërsa dëshirë e indoktrinuar është ajo dëshirë që merr si referencë transmetimin e “sapunoperave holivudiane” që transmetohen rrishtas në mendjet tona. Në këtë kontekst, femra është më shumë e prirur për të ndjekur këto sapunopera. Edhe në këtë kontekst femra ka arsytet e saj që e shtyjnë të shohin transmetime të tillë. Njëri nga këto është nevoja e vazhdueshme për romancë iluzive ose nga mungesa e kësaj romance në jetën e saj private. Dhe siç duket qartë, shumë prej nesh, në këtë stad, pra të joshjes spontane, nuk ekzaminojmë fundin e aktit, por biem preh e joshjes fizike. Kjo joshje fizike, më pas kthehet në makth të vërtet, sepse një nga hallkat e bashkimit kimik – shpërbëhet. Kjo hallkë, duket se është përsëri dëshira e pakontrolluar, e shafqur nga të dy gjinitë. Kjo dëshirë e pakontrolluar shfaqet më tepër te meshkujt sesa te femrat. Një ndër asyet që mashkullin e çojnë në këtë dëshirë të pangopur është testosteroni i tij, gjithnjë sipas mjekësisë konvencionale.

Ky hormon mashkullor që është më fluksiv në moshën e adoleshencës, përbën në vazhdimësi të jetës së mashkullit ngërçin dhe problematikën e tij më të madhe, kundrejtë gjinisë së bukur. Pra ky hormon, shkakton irracionalizëm për akt-marrjet e mashkullit-adoleshent apo edhe për të rriturit, dhe që gradualisht ky irracionalizëm kthehet në zemërim. Dhe kështu, asnjëri nga ne, qoftë në jetën familjare apo sociale, këto dy nocione të qënies njerëzore

nuk i ka peshuar dhe nuk i njeh në thellësi. Për fat të keq, këto dy nocione kaq të nevojshëm për t'u ekzaminuar dhe shqyrtuar, nuk shkollohen në asnjë vend të botës. E megjithatë, të gjithë kemi rënë në makthin e dëshirës së pakontrolluar qoftë kundrejtë gjinisë së kundërt, qoftë kundrejtë konsumit të të mirave materiale.

Për më shumë, kjo dëshirë ndërthuret edhe në politikë, ku më vonë merr formën e revolucionit, sepse sovranit “masa” nuk i kontrollon dot dëshirën, qoftë për fronin e tij, qoftë për pasurinë e tij. Më tej, kjo dëshirë kalon në stadin e zemërimit. Zemërimi është i barasvlershëm me konfliktin, mllefin dhe luftën. Nëse ky zemërim nuk çtensionohet nëpërmjet dialogut, i cili ka për qëllim që të identifikojë të vërtetën dhe të ç'tensionojë gjëndjen e zemërimit, atëherë, ky zemërim kthehet në shumë-shtresor, dhe shkakton zemërim më të madh, pra luftë në vetë-vete. Ky fenomen quhet ndryshe revolucion.

Në anën tjetër, në stadin pas-entuziast, çifti gjatë gjithë jetës së tij, lufton për të vërtetën ose “duheshmërinë” e aktit. Psh, përgjithësisht mashkullin e shqetëson veshja sensuale e partneres së tij, kur del jashtë shtëpisë apo qoftë edhe brenda në praninë e të tjerëve. Veshja sensuale në këtë kontekst ka të bëjë me atë veshje që provokon ndjenja apo shfaqje vulgare nga të panjohurit, jo pak të rralla, të llojit: “i'a vënça një herë kësaj kuçkës...” etj,. Kjo veshje, ndonëse në dukje pa ndonjë efekt negativ te partneri, shkaton zemërim dhe aty jashtë edhe provokim vulgar, provokim ky që është në dëm të vetë personit që e mbart por edhe të atyre që pak më lart u quajten irracional, për shkak të “hiper”-prodhimtarisë së tyre hormonale. Kjo më vonë, mund të rezultojë në përdhunim fizikë, dhe kjo vjen si pasojë e një përdhunimi sensual që i paraprin atij fizikë. Ky përdhunim sensual, që shfaqet me dhunë të pandërprer nga mjetet e komunikimit masivë, demonstroi edhe dëshirën e shfrenuar, që natyrisht në këtë stad është e pamoralshme, qoftë kundrejtë individit që dashurojmë, qoftë kundrejtë vetes. Në anën tjetër, nëse veshja është sensuale me të vetmin qëllim që të përçojë respekt apo vlera personaliteti, natyrisht që nuk do të krijonte zemërim konfliktual midis partnerëve. Në të njëjtën mënyrë mund të logjikohet dhe të kritikohet veshja e adoleshentëve, studentëve apo e qytetarëve të ndryshëm, që me naivitetin më të madh bien preh e logjikës perverte të dizenjatorit

dhe ateljes së tij, të veshjeve mashkullore që janë aq vulgare sa që fyejnë gjithë qytetatrinë humane; dhe këto janë të llojit: Të qënët i “dashuruar!” me shfaqjen e brekëve mbi pantallona, pantallonat poshtë belit, heqjen e tyre zvarrë dhe për tokë, pirsing, vetulla të hequra, sjellje femërore, etj si këto. Nuk do të marrim nën konsideratë këtu, kontekstin demokratiko-moral të dizenjatorit, as dhe logjikën e tij, sepse po të merrësh në konsideratë në këtë analizë do të n’a duhësh shumë hapësirë dhe do të devijonim nga tema jonë. Por kjo temë, dmth logjika e artit apo emetimit të tij në treg, do të jetë subjekt i një analize tjetër.

Por ç’është të qënët i dashuruar? A nuk është dashuria nevojë personale? Nëse e pohojmë se është nevojë, atëherë: Ç’është “nevoja”? Natyrisht mund të themi se kur ushqehemi, është nevojë biologjike. Pra në këtë rast jemi të varur nga *nevoja* për ushqim. Në raste të tjerë, kemi nevojë për ujë, për lojë, për sport, për njëritjetrin, e kështu me rradhë. Deri këtu, duket se dashuria është më shumë nevojë natyrale se sa nevojë normative. Në fakt, nevojë apo dashuri normative është ajo dashuri që predikon dashuri të llojit: Duaje tjetrin siç do veten! Kjo është normë sepse thjesht t’a thonë për t’a praktikuar dhe nuk është komponent natyral; në kontrast, komponent natyral është kur shfaqet natyralisht dhe spontanisht si nevojë. Në anën tjetër, për dashurinë e partnerit, duket se s’ka maksima biblike, kuranike apo institucionale të shoqërisë civile dhe partneri qoftë mashkull, qoftë femër – ecën në tymnajë, pa përcaktuar paraprakisht se çfarë është dashuria. Këto maksima, më tepër normative se sa natyrale kërkojnë që dashuria të jetë normë për një shoqëri duke ia imponuar dhe jo duke hulumtuar të natyrshmen e ndjenjës. Duhet thënë në këtë pikë, se, qëllimi i gjenealogjisë është të kërkojë komponentë natyralë dhe jo normativë, sepse normativiteti në gjenealogji është i barabartë me barbarizëm.

Barbarizëm është çdo gjë që vjen nga jashtë e imponuar, sepse nuk është e lindur natyralisht, por themeluar artificialisht. Psh, meqëse u referua në hyrje të këtij teksti Shën Valentini; ç’farë feste është kjo? Natyrisht e ardhur ose e imponuar në mënyrë artificiale nga mjetet e komunikimit masivë. Atëherë, çfarë ofron kjo për një shoqëri civile kur i imponohet? Asgjë!, veçse konsum sendesh sensual, intim

apo seksual, pijesh apo darkash. Pra, është një festë me të vetmin qëllim që të ofrojë konsum, rrjedhimisht kapital për ata që merren me këtë prodhim, shërbim apo shitje. Ndërkohë nëse pranojmë se këto sende apo kjo ditë e rinovon dashurinë tonë me një çtensionim organik, atëherë mund të themi njëlloj se çtensionimi është dashuri. Por kjo s'është e vërtetë: Kjo për vetë faktin se, dashuria duhet të jetë konsistente dhe jo inkonsistente. Nëse këtë inkonsistencë mjetet e komunikimit masivë e ushqejnë për t'a themeluar në ndërgjegjjen e tyre/tonë, atëherë do të kemi pseudo-dashuri, sepse ndonëse bashkëshortin, të dashurin apo flirtin e sapo lënë aty më tej e kishim pranë, ne nuk ndjemë dashuri. Të ndjesh dashuri atëherë, kërkon konsistencë të vazhdueshme. Por ç'është konsistenca? Konsistenca është akt-marrje logjike me të vetmin qëllim që të të çojë në empati. Atëherë, po empatia ç'është? Empatia është aftësia mendore e dikujt që të kuptojë me konsistencë nevojat, dëshirat dhe përvojat e dikujt. Në fjalë të tjera, të kuptojë se çfarë e shqetëson, e mundon, apo zemëron bashkëshortin e vet. Atëherë, n'a doli se, që dashuria të jetë e gjallë dhe vitale duhet të mbart konsistencë ose vijueshmëri logjike me të vetmin qëllim që të të çojë në empati. Deri këtu, duket se dashuria kërkon më shumë mundim logjikë sesa mundim fizikë. Por që të arrij dikush në këtë stad logjikë, duhet dhe të identifikojë ngërçet e bashkëshortit dhe t'u jap zgjidhje paraprake atyre ose t'i marrë nën konsideratë për t'i zgjidhur më vonë. Shpesh herë këto zgjidhje për dikë që nuk e njeh këtë rrugë, pra konsistencën mendore dhe empatinë logjike janë dështake, dhe krijojnë atë që pak më lartë u konsiderua si irracionalizëm gjinor.

Në vazhdim, duhet të ekzaminojmë nga më afër dashurinë në stadin e nevojës në kombinim me konsistencën mendore dhe empatinë logjike. Kështu, nëse pohojmë sërish se dashuria është nevojë, atëherë mund të themi një lloj se ajo është varësi njëkohësisht. Por të jesh i varur ndaj dikujt përmes ndjenjave dhe logjikës tonë, ne rrezikojmë të humbasim pavarsinë, atë çka kemi thënë në tekste të tjerë¹, pra autonominë tonë, të cilën në hapat e parë të jetës sonë prindërit n'a e

¹ Rreth «Besimt» Socio-Familjar dhe të «Vërtetës» së Trurit

dhurojnë natyralisht. Pra, gjëndemi në një situatë varësie ndjenjash dhe mendimesh që n'a çojnë pa e kuptuar në varësi, që në një stad më të zhvilluar kalon në skllavërim. Skllavërim në këtë stad janë thëniet e llojit: Unë pa ty vdes! Ose, unë nuk mund të jetoj pa ty! Ose, unë nuk dua asnjë tjetër përveç teje! Kjo rezulton më vonë nga të dyja gjinitë në ndarje. Përse ndodh kjo atëherë? Sepse bie ndesh me atë që jemi mësuar në moshë më të re, pra mosha e autonomisë, që shpesh është mosha e adoleshencës, ku të dyja gjinitë fillojnë të çiftëzohen. Dhe natyrisht, asnjëri nga këta të rinjë nuk e ka të ekzaminuar paraprakisht varësinë apo "humbjen" e lirisë nëse lidhen me dikë, pa ditur implikacionet që mbart kjo lidhje. Këto problematika ndeshen atëherë kur çifti kërkon ekskluzivitet ndaj tjetrit. Dmth, kontroll dhe dyshime të vazhdueshme. Sepse ekzaktësisht në këtë stad, është futur nocioni i varësisë.

Kujdes!, kjo mund të krahasohet shumë bukur me pushtetin legjislativ i cili pretendon varësi të të njëjtit lloj, dmth, humbjen e autonomisë së individit, sepse në këtë stad, individi nuk operon me ndërgjegjjen e tij, por me ndërgjegjjen e legjislativit. Kjo dukuri më pas ka efektet e vet negativ në shoqërinë civile. Njeriu në këtë situatë gjëndet midis dualizmit autonom dhe humbjes së autonomisë. Kjo e bën individin të humbas ndërgjegjjen, pra kërkon apo detyrohet që "gjahun t'a zërë me duart e një tjetri", sepse nuk operon dot në autonomi, sepse shumë thjesht e ka humbur atë. Kjo dukuri më vonë, kalon në zemërim dhe n'a nxjerr sërish te revolucioni i shquar më lart.

Natyrisht që në këtë pikë mund të ngrihet pyetja: Përse morali është produkt i dashurisë? Morali është "dikta" për të treguar se si duhet bërë diçka dhe ndjenjë rregullimi të akteve se çfarë është e drejtë dhe e gabueshme për të ndërrmarrë; dashuria është më shumë ndjenjë sesa logjike dhe nuk merrë nën konsideratë aktin në shikim të parë. Morali kultivohet por është edhe i brendaqënësishëm, ndërsa dashuria lind natyrisht me të vetmin qëllim që të ndaj me dikë tjetër etikën e vetë. Etika e dashurisë është të krojoi kushtet për lumturi të vazhdueshme, ndërsa morali është instrumenti i saj. Dashuria rivendikon respekt ndaj tjetrit dhe vetes dhe dinjitet ndaj vetes. Morali rivendikon respekt ndaj vetes dhe dinjitet ndaj tjetrit. Në aparencë duken si dy fjalë që s'kanë ndarje, por në realitet kanë: Morali është edhe i natyrshëm edhe i kultivuëshëm; dashuria është po e njëjta gjë, sepse kërkon konsistencë-empati, por, ne më parë e duam diçka pastaj e moralizojmë, pra e kthejmë në normë. Kjo ndarje është e novojshtme që të merret nën konsideratë, ndryshe individi do të jetojë jo dashurinë, por ferrin.

Si t'i shmangemi atëherë kësaj varësie ndjenjash, konsistence dhe empatie? Më të vërtet gjëndemi në një situatë shumë të vështirë individuale – dhe kjo është: Autonomia kundër varësisë. Antidoda për t'iu shmangur një situatë të tillë, do të ishte e llojit: Jo kundër dashurisë, por të dashurojmë me logjikë pa mohuar ndjenjat; kundër dashurisë me ndjenja të forta por pro dashurisë ndjenjë-logjike; balancë midis ndjenjave dhe logjikës; jo kundër konsistencës por kundër inkonsistencës; jo kundër empatisë por kundër anempatisë. Të gjitha këto balanca ndjenjash dhe logjike do t'a ruanin dashurinë tonë në nivele vitale dhe të gjallërueshme. Nëse dikush nuk i njeh këto balanca atëherë çiftëzimi apo zgjedhja jonë për dikë do të dështojë ose do të jetë produkt negativ. Ky negativitet do të trashëgohet edhe në gjenerata të tjera dhe "vërtetësia e dashurisë" do të jetë nocion i pahulumtueshëm, ndonëse mund të përflitet dhe të diskutohet shumë herë për këtë dëshirë të pashtershme.

Por që të ketë rezultate të tilla dashuria jonë, dmth mos të shteroj kurrë, duhet që midis

çiftit të ketë post-audiençë, dmth dashuria e tyre të jetë e hapur, dialoguese, kognitive, njohëse, përfshirëse, etike dhe ndonjë herë edhe e moralshme. Sepse pikërisht dashuria nuk duhet të ngatërrohet me moralin: Morali është produkt i dashurisë. Natyrisht që në këtë pikë mund të ngrihet pyetja: Përse morali është produkt i dashurisë? Morali është “dikta” për të treguar se si duhet bërë diçka, dhe ndjenjë rregullimi të akteve se çfarë është e drejtë dhe e gabueshme për t’u ndërrmarrë, e bukur dhe e shëmtuar; dashuria është më shumë ndjenjë sesa logjike dhe nuk merrë nën konsideratë aktin në shikim të parë. Morali kultivohet por është edhe i brendaqënësishëm, ndërsa dashuria lind natyrisht me të vetmin qëllim që të ndaj me dikë tjetër etikën e vet. Etika e dashurisë është të krojojë kushtet për lumturi të vazhdueshme, ndërsa morali është instrumenti i saj. Dashuria rivendikon respekt ndaj tjetrit dhe vetes dhe dinjitet ndaj vetes. Morali rivendikon respekt ndaj vetes dhe dinjitet ndaj tjetrit. Në aparençë duken si dy fjalë që s’kanë ndarje, por në realitet kanë: Morali është edhe i natyrshëm edhe i kultivueshëm; dashuria është po e njëjta gjë, sepse kërkon konsistencë-empati, por, ne, më parë e duam diçka pastaj e moralizojmë, pra e kthejmë në normë. Kjo ndarje është e nevojshme që të merret nën konsideratë, ndryshe individi do të jetojë jo dashurinë, por ferrin.